



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 26  
Prishtinë, më 1 tetor 2018, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Valon Ramadani, Avdullah Hoti, Andin Hoti, Emilija Rexhepi, Etem Arifi, Albert Kinolli dhe Ali Lajçi.

**Munguan:** Verica Qeraniq dhe Faton Topalli.

**Stafi mbështetës:** Mehmet Simnica, Ajet Avdullahu dhe Endrit Rrustemi.

**Pjesëmarrësit tjerë:** Albert Krasniqi, Diellëza Luzha dhe Bleronë Hoxha, KDI; Besiana Bajrami nga “Ekonomia Online”, Erjonë Popova nga BIRN, Vatra Qehaja nga LVV dhe Erdita Shaqiri nga Handikos.

**Mbledhjen e kryesoi:** Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 31.7.2018;**
- 3. Shqyrtimi i raportit të punës së KMFP-së për sesionin pranveror për vitin 2018;**
- 4. Diskutim për sa i përket auditimit të raporteve financiare dhe atyre të deklarimit financiar të subjekteve politike për vitin 2017;**
- 5. Të ndryshme.**

*Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 31.7.2018

### *Përfundim*

*Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 31.7.2018, u miratua pa vërejtje.*

## 3. Shqyrtimi i raportit të punës së KMFP-së për sesionin pranveror për vitin 2018

**Kryetari** njoftoi se administrata ka përgatitur një raport narrativ të punës së komisionit për sesionin pranveror, dhe nëse nuk keni ndonjë vërejtje ose sugjerim, do të shkojmë me një miratim formal.

### *Përfundim*

*Shqyrtimi i raportit të punës së KMFP-së për sesionin pranveror për vitin 2018, u miratua pa vërejtje.*

## 4. Diskutim për sa i përket auditimit të raporteve financiare dhe atyre të deklarimit financiar të subjekteve politike për vitin 2017

**Kryetari** ua rikujtoi deputetëve se KMFP i ka rekomanduar administratës së Kuvendit, që të zhvillojë procedurat e prokurimit, duke shpallur tender për auditimin e financave të partive politike për vitin 2017.

Ai tha se informatat që i kemi nga administrata, janë që tri prokurime kanë dështuar, sepse nuk ka pasur asnjë ofertues. Po ashtu, ai theksoi se vazhdimisht, Kuvendi ka pasur vërejtje në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, që nuk kemi arritur të zhblokojmë procesin e auditimit. Arsyet për këtë bllokadë, duket se janë shuma e parave që janë ndarë për këtë çështje. Tani jemi në situatë ku duhet të diskutojmë për modalitetet sesi duhet të ecim tutje, nëse duhet të propozojmë rritjen e buxhetit. Nëse po, sa mjete më shumë duhet kërkuar? Ai tha se, sipas analizës së shkurtër, zyra mbështetëse ka bërë një kalkulim që për auditimet e vitit 2013 – 2016, kanë qenë rreth 213 raporte dhe çmimi për raport ka qenë rreth 563€. Për vitin 2017, ata do t'i draftojnë 117 raporte. Në bazë të shumës që ne ua kemi ndarë atyre, iu del një raport 265€. Nga kjo del që, nëse e bëjmë një raport me 563€, i bie që ne duhet të shtojmë shumën prej 35.000€. Kjo është marrë si referencë, pra çmimi i raporteve të kaluara. Tani po më interesojnë edhe vlerësimet e juaja sesi e shihni këtë çështje.

**Andin Hoti**, tha se kompanitë duhet të arsyetojnë shumën që e kërkojnë. Çfarë shpenzimesh kanë?

**Ali Lajçi**, tha se ka kompani që nuk ka dëshmuar me ndonjë projekt, sepse i nevojitet shuma e tillë e mjeteve. Po ashtu, pyeti: A jemi ne të obliguar të bëjmë kalkulime dhe të ndajmë një buxhet të tillë? Ai tha se ndoshta nuk duhet ta miratojmë fare këtë raport.

**Kryetari** rikujtoi se nuk ka raport për miratim, por ajo se çka duhet të bëjmë është se duhet të rekomandojmë ose jo, rritjen e buxhetit.

**Avdullah Hoti**, tha se ne nuk kemi vlerësim nga Departamenti i Prokurimit, se mbi cilën bazë janë ndarë këto 30.000€. Ai tha se kjo shumë e ndarë është bërë pa ndonjë analizë dhe si zgjidhje propozoi që sekretari i Kuvendit dhe drejtori i Prokurimit, t'i dërgojnë shkresë KRPP-së, që në bazë të kontratave paraprake, të japin vlerësimin e kostos së kryerjes së këtij aktiviteti, e mandej ne të kërkojmë ndarjen e buxhetit.

**Andin Hoti**, tha se ndoshta mund që prokurimi të fillojë procedurat normale, pa cekur fare shumën, që pastaj ofertuesi më i lirë të fitojë tenderin, mandej të ndahen mjetet.

**Avdullah Hoti**, tha se kjo nuk mund të bëhet, sepse duhet pasur mjete të ndara për procedurë të prokurimit. Ai, gjithashtu, tha se duhet kërkuar koston e përmasave dhe të shkojmë me procedurën e shkurtuar.

### ***Përfundim***

*KMFP vendosi që të kërkojë nga sekretari i Kuvendit dhe drejtori i Prokurimit, një vlerësim të kostos së kryerjes së auditimit të raporteve financiare dhe atyre të deklaramit financiar të subjekteve politike për vitin 2017.*

### **5. Të ndryshme**

**Kryetari**, tha se ka ardhur Raporti vjetor i auditimit dhe se kemi obligim që deri më datën 31 tetor, ta dërgojmë në seancë për miratim. GIZ-i ka kërkuar që më datën 10 tetor, të bëjmë një punëtori të përbashkët me Komisionin për Buxhet dhe auditorin dhe pastaj të mbajmë një mbledhje të komisionit, që eventualisht të nxjerrim disa rekomandime dhe pastaj ta procedojmë në seancë.

**Kryetari**, gjithashtu, tha se kanë ardhur raportet për organizatat buxhetore dhe se për mbledhjen e radhës propozoi që të merremi me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Stacionin e Autobusëve.

**Avdullah Hoti**, tha se pasi të gjitha raportet nuk mund t'i shqyrtojmë, është mirë që t'i shqyrtojmë ato që kanë më shumë buxhet.

**Kryetari**, tha se kemi menduar që t'i shqyrtojmë vetëm ato raporte, të cilat kanë vlerësim negativ, kurse ato që kanë dalë mirë, të mos humbet kohë me to.

**Mërgim Lushtaku**, tha se ka një propozim për zbatimin e ligjit për Kryqin e Kuq. Ai tha se është mirë që të ftojme guvernatorin e BQK-së dhe zyrtarët e saj, sepse ka marrë vërejtje nga zyrtarët e Kryqit të Kuq, për zbatimin e këtij ligji.

**Avdullah Hoti**, tha zbatimi i këtij ligji nuk i përket KMFP-së. Më shumë është në fushëveprimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, meqenëse ata e shqyrtojnë Raportin e punës së BQK-së. Ai, gjithashtu, tha se çështja në fjalë nuk ka të bëjë me para publike, por është vetëm obligimin tatimor i kompanive të sigurimit.

### ***Përfundim***

*KMFP vendoi që komisioni të mbajë punëtori të përbashkët me Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, më datën 10 tetor 2018.*

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**  

---

**Driton Selmanaj**